

VENDIM
Nr. 880, datë 19.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda datës 25.12.2012, të përfundojë procedurat e prokurimit për furnizimin me mallra, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, për vitin 2012, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe njoftimi i këtyre kontratave të nënshkruara në Agjencinë e Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha